



University Ukshin Hoti Prizren

Universiteti i Prizrenit Univerziteti Prizren Prizren Universiteti <b>“UKSHIN HOTI”</b> F. i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit	
Pranuar me dt.	06.03.2024
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
507	01-57

**FAKULTETI I SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT**  
**FACULTY OF LIFE AND ENVIRONMENTAL SCIENCES**

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI PËR PRAKTIK**

**Lënda: Kryerja e Praktikës Profesionale për Studentët e nivelit bachelor "Agrobiznes" dhe master "Menaxhim në agrobiznes" të Fakultetit të (më tej FSHJM të Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren (më tej Universiteti)**

**NENI 1**

Ndermarrja MEDINA sh.p.k

e përfaqësuar nga Z. Allden Bajrami me detyrë Drejtor i kompanisë dhe Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit (FSHJM) përfaqësuar nga Prof. Asoc. Dr. Albana Milaimi, Dekane i këtij Fakulteti, lidhin me vullnet të lirë këtë kontratë.

Kandidatja: Nehale Abazi.

**NENI 2**

**Institucioni//Ndërmarrja merr persiper:**

1. Të presë, të asistojë teknikisht dhe të monitorojë për një semestër të vitit akademik studentin/tët duke caktuar një nga punonjësit e vet si udhëheqës të tij. Udhëheqësi të jetë një specialist me përvojë sa më të madhe të jetë e mundur dhe sa më afër profesionit të studentit dhe objektivave të praktikës.
2. Të krijojë sa të jetë e mundur kushte lehtësuese, si vendqëndrim të përkohshëm në një zyrë, transport brenda zonës së praktikës brenda mundësive duke shfrytëzuar udhëtimet e automjeteve të veta për qëllime pune.

3. Të vlerësojë me shkrim punën, angazhimin dhe efektivitetin e praktikës profesionale të studentit, duke u ndalur veçanërisht në përfitimet e realizuara prej tij dhe në sugjerimet për fakultetin me qëllim përmirësimin e praktikës së studentëve të tjerë në të ardhmen.

Vlerësimi i përcillet zyrtarisht fakultetit në fund të punës praktikës.

### NENI 3

Gjatë kohës së punës praktikës studenti zbaton orarin dhe detyrat që i cakton udhëheqësi në përputhje me kërkesat e programit të praktikës dhe me përmbajtjen e kësaj kontrate

### NENI 4

**Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit (FSHJM) merr përsipër:**

1. Të dërgojë studentin/ët e FSHJM në praktikë në afatin e caktuar.
2. Të mbajë lidhje dhe të komunikojë me ndërmarrjen për problemet eventuale dhe për ecurinë e praktikës.
3. Të kontrollojë herë pas here procesin e kryerjes së praktikës nga studentit me qëllim të dhënies së ndihmës dhe rritjen e efektivitetit të saj
4. Të vlerësojë praktiken e kryer nga studentët në përfundim të saj.

### NENI 5

Mosmarreveshjet eventuale midis palëve do të zgjidhen me bashkëbisedim ose konsensus të dyanshëm

U lidh me datën 01.03.2024

**Për Ndërmarrjen**

**Për Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit**

**MEDINA shpk**

**DREJTORI**

**ALLDEN BAJRAMI**

*Allden Bajrami*



**DEKANI**

**Prod. Asoc. Dr. Albana Milaimi**

